



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

EDICIONI I GJASHTË

BULETINI INFORMATIV

(Prill, maj, qershor)

Në këtë edicion, ndër tjerash
mund të lexoni:

- Autoriteti sqaron ngritjen e çmimit të vajit
- AKK pranon vlerësime pozitive për punën gjatë vitit 2020
- Zhvillohen aktivitete të ndryshme avokimi



Funded by
the European Union



KUVENDI MIRATON RAPORTIN E PUNËS SË AKK-SË KURSE AUDITORI NUK GJEN VËREJTJE NË PASQYRAT FINANCIARE

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Raportin e Punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2020. Në seancën e mbajtur më 27 maj, 65 deputetë kanë votuar për miratimin e këtij raporti, ndërsa nuk ka pasur vota kundër. Gjithashtu, deputetët kanë miratuar edhe Raportin Financiar të AKK-së për vitin 2020.

Përkundër pengesave të shkaktuara nga përhapja e pandemisë COVID-19, gjatë vitit të kaluar Autoriteti i Konkurrencës ia ka dalë që me sukses të zbatojë mandatin e tij. Gjatë asaj periudhe, Autoriteti i Konkurrencës ka trajtuar disa raste të mëdha dhe komplekse si dhe ka punuar drejt ndryshimeve të legjislacionit primar.

Gjithashtu, rëndësi i është kushtuar edhe avokimit për politika të konkurrencës, duke nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me institucione të ndryshme, duke takuar përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të biznesit dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Fokus i rëndësishëm i është kushtuar edhe trajnimit të mëtejshëm të stafit, me mbajtjen e një numri të konsiderueshëm të trajnimeve me ekspertë të dëshmuar ndërkombëtar e vendor në fushën e konkurrencës.

Vetëm pak javë pasi Kuvendi i Kosovës miratoi Raportin e Punës, AKK ka marrë një tjetër vlerësim pozitiv. Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka gjetur vërejtje në pasqyrat financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin e kaluar.

Në Raportin e Auditimit, ndër tjerash thuhet se "Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme".

PËRFUNDON MANDATI PESËVJEÇAR I KRYETARIT DHE KOMISIONIT



Mandati i Kryetarit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe katër anëtarëve të tjerë të Komisionit të AKK-së ka përfunduar më 9 qershor.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës me mandat pesë vjeçar, dhe me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Gjatë pesë viteve të fundit, AKK është udhëhequr nga Kryetari z.Valon Prestreshi, Nënkryetari z. Ahmet Krasniqi, të cilët kanë qenë pjesë përbërëse e Komisionit pesë-anëtarësh. Tre anëtarët e tjerë të Komisionit kanë qenë: znj. Fatime Haziri, z. Muhamet Krasniqi dhe z. Shaqir Morina.

Në përfundim të mandatit të tyre, kolegët e AKK-së janë mbledhur për të festuar sukseset e arritura gjatë pesë viteve të fundit dhe për të falënderuar komisionerët për punën e tyre.

Komisionerët e deritashëm të AKK-së kanë të drejtë për rizgjedhje edhe për një mandat të ri, por deri më tani Kuvendi i Kosovës nuk ka votuar për anëtarët e rinj.

AKK SQARON RITJEN E ÇMIMIT TË VAJIT USHQIMOR NË TREGUN E KOSOVËS

Në fillim të muajit qershor, Autoriteti i Konkurrencës ka publikuar gjetjet e një monitorimi të kryer në tregun e Kosovës pas shqetësimeve të ngritura lidhur me ngritjen e çmimit të vajit ushqimor, më konkretisht të vajit të lulediellit.

AKK ka konfirmuar se ka pasur një rritje të theksuar të çmimit të këtij produkti nga muaji janar i këtij viti, andaj menjëherë janë nisur procedurat për të parë nëse operatorët e tregut kanë bërë ndonjë shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë caktimit të çmimit. Bazuar në këtë ligj, bashkërendimi i operatorëve të tregut për ta caktuar çmimin e ndonjë produkti mund të jetë veprim që bie ndesh me ligjet në fuqi që e mbrojnë konkurrencën e ndershme në vendin tonë.

Sidoqoftë, nga monitorimi i kryer në terren si dhe nga mbledhja e të dhënave nga institucionet shtetërore, është ardhur në përfundim që nuk ka elemente të ndonjë marrëveshjeje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar ndërmjet importueseve të vajit në Kosovë. Në fakt, monitorimi ka gjetur se rritja e çmimit të vajit ushqimor është rritje globale, e cila pastaj reflekton në mënyrë zinxhimore edhe në shtetin tonë, si importues i këtij produkti.

Çmimet e vajit të lulediellit në tregun botëror do të ndryshojnë ekskluzivisht në varësi të furnizimit dhe kërkesës. Në vitin 2020, shumë prodhues të mëdhenj botërorë, si Ukraina, Rusia,

Bullgaria, Rumania, Moldavia, kishin një rendiment më të dobët të lulediellit, gjë që ndikoi në mënyrë të pashmangshme në këtë trend të çmimeve në bursat botërore. Një rol në ngritjen e çmimit ka pasur edhe ndryshimi në politikat e disa vendeve që janë eksportues të mëdhenj, si çmimit ka pasur edhe ndryshimi në politikat e disa vendeve që janë eksportues të mëdhenj, si fiksimi i politikave të importit dhe vendosja e taksave mbi vajin ushqimor.

Sa për të pasur një pasqyrë edhe më të sakët të këtij efekti, ne kemi analizuar edhe çmimet e këtij produkti në tregjet e vendeve të rajonit. Për shembull, hulumtimi i tregut shqiptar jep rezultatet e një shtrenjtimi të vajit ushqimor gjatë vitit 2021. Çmimet e vajit për gatim panë një shtrenjtim të shpejtë në fillim të këtij viti, teksa shitësit me pakicë paralajmërojnë rritje të mëtejshme gjatë vitit 2021. Situatë e ngjashme është edhe në Serbi, që është eksportuesi më i madh i vajit në Kosovë.



MBAHET TRAJNIM PËR KONKURRENCËN ME ZYRTARËT E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

Një trajnim lidhur me zbatimin e ligjit dhe politikave të konkurrencës në sektorin bankar dhe të shërbimeve financiare u mbajt më 1 dhe 2 qershor për zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës (AKK) dhe të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

Qëllimi i këtij trajnimi - i organizuar në bashkëpunim me Projektin "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore – ishte përfitim i ekspertizës në këtë fushë përmes ekspertëve të angazhuar nga Projekti. Gjithashtu, përmes kësaj ngjarjeje, është synuar që të promovohet një bashkëpunim më i thellë mes AKK-së dhe këtij rregullatori të rëndësishëm sektorial.

Ish-kryetari i AKK-së, z. Valon Prestreshi, ka thënë në fjalën e tij hyrëse se megjithëse ata kanë bashkëpunuar me BQK-në edhe në të kaluarën, kjo punëtori ishte veçanërisht e rëndësishme sepse AKK-ja synon të kryejë një studim të tregut mbi shërbimet bankare dhe financiare. Ai shtoi se "ky është një nga sektorët më të rëndësishëm në vend. Prandaj ne jemi shumë të interesuar të sigurohemi që ekziston një konkurrencë e shëndetshme midis operatorëve të këtij tregu, që është thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit".

Trajnimi u zhvillua nga ekspertët e Projektit, Profesor Michael Saller dhe Z. Daniel Colgan, të cilët prezantuan tema të ndryshme në lidhje me politikën e konkurrencës dhe zbatimin në tregjet bankare dhe të sigurimeve bazuar në ligjin e BE-së.



MBAHET LIGJËRATË RRETH POLITIKAVE TË KONKURRENCËS PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT HAXHI ZEKA

Ish-kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, ka mbajtur më 17 maj një ligjëratë për studentët e Universitetit Haxhi Zeka në Pejë.

Në ligjëratën për studentët e Fakultetit Juridik, niveli Master, Prestreshi ka prezantuar për ligjin dhe politikat e konkurrencës, punët e AKK-së viteve të fundit si dhe ka sqaruar disa prej rasteve të rëndësishme që janë trajtuar nga AKK.

Në këtë vizitë, Prestreshi ka qenë i shoqëruar nga Inspektori Hetues, Adrian Mustafa, i cili po ashtu ka ndarë përvojën e tij të punës në AKK para studentëve të këtij universiteti. Kohëve të fundit, Autoriteti i Konkurrencës ka shtuar angazhimet për të avokuar në sferën akademike.

Më konkretisht, AKK ka nënshkruar këtë vit memorandume me dy kolegje private për të përfshirë një lëndë për konkurrencën në kurrikulat studimore të tyre.

Gjithashtu, ligjëratat e ngjashme janë zhvilluar edhe në të kaluarën



SYNOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT ME AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

Në fillim të muajit prill, ish-kryetari Valon Prestreshi dhe Drejtori i Përgjithshëm, Sakip Imeri, janë takuar me përfaqësuesit e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Gjatë atij takimi është diskutuar për një mori çështjes me interes për të dy institucionet.

Kryeshefi i AZHB-së, z. Nazmi Zenelaj, e ka informuar Autoritetin e Konkurrencës lidhur me disa problematika që kërkojnë ndërhyrjen e AKK-së, kurse nga ana e tij, Prestreshi i shprehu përkushtimin që të thellohet bashkëpunimi mes dy palëve për ofrimin e zgjidhjeve.

Kryetari Prestreshi ka thënë gjatë takimi se në të ardhmen, bashkëpunimi mes dy institucioneve do të thellohet dhe konkretizohet tutje përmes një Memorandumi të Bashkëpunimit



PUBLIKOHEN 10 FLETUSHKA INFORMATIVE PËR POLITIKAT E KONKURENCËS

10 fletushka informative lidhur me politikat e konkurrencës, të cila janë përgatitur në bashkëpunim me Projektin “Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore”, janë publikuar në muajin qershor. Këto 10 broshura poashtu janë përmbledhur në një Udhëzues të posaçëm për Ligjin dhe Politikat e Konkurrencës

Këto fletushka – të cilat janë publikuar në formë elektronike por edhe të shtypura – ofrojnë informacione bazike për rolin e AKK-së dhe për politikat e konkurrencës në përgjithësi.

Qëllimi i tyre është që të avokohet lidhur me konkurrencën e ndershme dhe përfitimet e saj. Ato do t'i ofrohen qytetarëve të cilët vizitojnë zyrat e AKK-së për të adresuar çështje të ndryshme si dhe do të ndahen edhe me institucione të ndryshme.

Disa nga broshurat e përgatitura shtjellojnë këto tema: Rëndësia e konkurrencës për ekonominë e Kosovës; Detyrimet ndërkombëtare të Kosovës për të vepruar me një politikë moderne të konkurrencës; rregullat e konkurrencës në Kosovë; marrëveshjet e ndaluara të konkurrencës; pozitat dominuese dhe abuzimi me këto pozita, e të tjera.




AKK, ME PËRKRAHJE TË PROJEKTIT TË KOMISIONIT EVROPIAN, DO TË ANGAZHOJË DY PRAKTIKANTË

Gjatë muajit qershor, Projekti “Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore” ka hapur një konkurs për pranimin e gjashtë praktikantëve, të cilët do të angazhohen me punë me pagesë për disa muaj në tri institucionet që janë përfitues të këtij projekti: dy në Autoritetin e Konkurrencës, dy në Komisionin e Ndihmës Shtetërore dhe dy të tjerë në Departamentin e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Financave dhe Punës dhe Transfereve.

Qëllimi i Programit të Praktikës është që t’iu mundësojë këtyre të rinjve për të fituar përvojë pune dhe trajnim në fushat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore në një periudhë deri në 9 muaj.

Praktikantët e përzgjedhur fillimisht do të trajnohen nga stafi i Projektit, e më pas do t’i caktohen një mbikëqyrësi specifik në organizatën përkatëse dhe do të angazhohen në asistim në analizën dhe zhvillimin e rasteve; kryerjen e hulumtimeve mbi praktikën gjyqësore dhe çështje të tjera siç kërkohen nga organizata përfituese; organizimin dhe marrjen pjesë në takime/përgatitja e procesverbalit; organizimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve; hartimin e materialeve mediatike; përditësimin e platformave të mediave sociale.



**EU Support to the Kosovo
Competition Authority and
the State Aid Commission**





AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



**Funded by
the European Union**



Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.